

VENDIM
Nr. 356, datë 25.6.2025

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 718, DATË 29.10.2004, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR LISTËN E PERSONAVE TË SHPALLUR SI FINANCUES TË
TERRORIZMIT”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 14, pika 1, 18, pika 1, e 25, pika 1, të ligjit nr. 157/2013, “Për masat kundër financimit të terrorizmit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në listën e personave të shpallur sipas rezolutave të Këshillit të Sigurimit (“Lista e OKB-së”), që i bashkëlidhet vendimit nr. 718, datë 29.10.2004, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhet kjo shtesë:

Në listën e shkronjës “C”, të titulluar “Lista e individëve anëtarë ose bashkëpunëtorë me organizatat ISIL (*Da’esh*) dhe *Al-Qaida*”, shtohet një individ, i renditur në shkronjën “a”, sipas shtesës që i bashkëlidhet këtij vendimi, në listën e konsoliduar të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, për personat që janë anëtarë, bashkëpunëtorë apo financues të organizatave ISIL (*Da’esh*) dhe *Al-Qaida*.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

PËRDITËSIMI NË LISTËN E PERSONAVE TË SHPALLUR SI FINANCUES TË
TERRORIZMIT

SIPAS REZOLUTAVE TË KËSHILLIT TË SIGURIMIT TË OKB-së
 (“LISTA E OKB-së”)

C. LISTA E INDIVIDËVE ANËTARË OSE BASHKËPUNËTORË ME
ORGANIZATAT ISIL (*Da’esh*) dhe *Al-QAIDA*

a) Shtim në “Listën e individëve anëtarë ose bashkëpunëtorë me organizatat ISIL (*Da’esh*) dhe *Al-Qaida*”;

1. ABUBAKAR SWALLEH

Shënim. Gjenealogjet e tjera për personin, emri i të cilit është radhitur më sipër, mbahen në Agjencinë e Inteligjencës Financiare.